




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data:	Zyrt. 04/ 42 / dt.12/02/2019
Për:	Zyrës së Informimit në Kuvendin Komunal, Zyrës së pranimt dhe Arkivës pranë KK-së, SLA-së, Radio Gjakovës
Nga:	Drejtor i Drejtorisë për Arsim Mr.Sc.Bernard Frrokaj
Përmes:	Drejtorisë së Arsimit
Lënda:	Konkurs



Në bazë të Ligjit mbi Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr. 03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, Ligjit të Punës neni 8, Udhëzimit Administrativ (MASHT) NR. 10/2018 Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimin Administrativ 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, Udhëzimit Administrativ 17/2009 Procedura e Zgjedhjes së Personelit Arsimor në Shkollë, Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, shpall/rishpallje :

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Nr	Institucioni	Pozita	Vend i lirë / Zëvendësim
1.	Gjimnazi "Hajdar Dushi" në Gjakovë	Një (1) mësimdhënës/e të lëndës Gjuhë Frënge me 20 orë mësimi në javë	Pushim i lehonisë
2.	SHMT "Nexhmedin Nixha" në Gjakovë	Një (1) mësimdhënës/e të lëndës profesionale "Dizajn i tekstilit dhe veshjeve" me 10 orë mësimi në javë	Me kohë të caktuar
3.	SHFMU "Fehmi Agani" në Gjakovë	Një (1) mësimdhënës/e të lëndës Edukatë Muzikor me 13 orë mësimi në javë	Pushim i lehonisë
4.	SHMU "Mazllum Këpuska" në Gjakovë	Një (1) mësimdhënës/e të lëndës Gjuhë shqipe me 20 orë mësimi në javë	Me kohë të caktuar
5.	SHFMU "Engjëll Gjoni" në N.e Ulët	Një (1) mësimdhënës/e të lëndës Histori-Ed.Qytetare me 12 orë mësimi në javë Një (1) mësimdhënës/e të lëndës Matematikë me 20 orë mësimi në javë	Zëvendësim pozita e Drejtorit të shkollës Me kohë të caktuar
6.	SHFMU "Durak Ahmeti" Demjan 1	Një (1) mësimdhënës/e të Programit Fillor	Me kohë të caktuar
7.	SHFMU "Zekeria Rexha" në Gjakovë	Një punëtor Tek.-Shërbyes	Me kohë të caktuar
8.	SHFMU "Deshmoiret e Hereqit" në Hereqit	Një punëtor Tek.-Shërbyes	Me kohë të caktuar

Aplikacionit i bashkangjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në DKA apo shkarkohet nga ëeb-faqja e Komunës i cili shërben për të konkuruar për shkollë/vend pune të cilët ka kualifikimin adekuat).
- Rezymeja Personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) i fotokopjuar;
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara tek noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh;**
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka);
-

I. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit arsimor:

- Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ Nr.06/2015 Normativi Për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional si dhe akteve juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr.02/L-52, Ligji Nr.03/L-068 dhe Ligji Nr.04/L-138). **Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre Udhëzimeve Administrative nuk do të shqyrtohen, përkatësisht refuzohen.**

II. Për vendet e lira në institucione edukativo-arsimore, kohëzgjatja e kontratës është me afat të caktuar, e cila do të definohet në kontratën e punës, por jo më gjatë se me datë 31.08.2019.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) pranohen nga data 12/02/2019 dhe përfundon me 26 /02/2019 deri në ora 15:00 në Zyrën e Pranimit dhe Arkivës pranë Komunës së Gjakovës.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT. Për intervistë do të ftohen ata kandidatë që hyn në rrethin e ngushtë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve juridike të lartcekura.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Orari i intervistës do të publikohet në tabelën e shpalljeve në DKA.

Suksese !